



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 123/3 prot.

Tiranë, më 12. 04. 2023

**V E N D I M**

**Nr. 57, datë 12. 04. 2023**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup> shqyrtoi ankesën nr. 15 Regj., datë 19.01.2023<sup>3</sup>, të shtetases F. G., kundër Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (në vijim MAS), me pretendimin për diskriminim për shkak të *bindjeve politike*<sup>4</sup> dhe *çdo shkak tjetër*<sup>5</sup>.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në këtë kuadër, F. G. ka parashtruar ndër të tjera në ankesë se: “...jam mësuese e profilit Matematikë - Fizikë, me një eskperiencë rreth 30 vjeçare si mësuese. Gjithashtu, gjatë karrierës time kam qenë dhe drejtuese në dy shkolla në Tiranë, në vitet 2006 - 2010. Përpos eksepriencës si mësuese, kam 18 vite që shkruaj opinione në shtypin e shkruar (gazeta) si dhe në portale për problemet e arsimit, duke sugjeruar zgjidhjet më të mira, sipas meje, për to. Në ato çka unë shkruaj jam kritike kundrejt mënyrës si drejtohet në arsim; se si zgjidhen drejtuesit; shkeljet e legjislacionit në arsim dhe jo vetëm, përfshirë dhe zbatimin e ligjit në mënyrë selektive ndaj mësuesve, trajtimin e mësuesve me shumë standarde, përdorimin e nxënësve, prindërve ndaj mësuesve, presionet ndaj mësuesve;...; shtypjen e fjalës së lirë (të mos paturit të drejtë të shprehësh lirshëm mendimin tënd). Me një kërkim të thjeshtë në Google dalin shumë nga shkrimet e mia.

Përpos, më duhet të theksoj se jam e djathtë, simpatizante dhe anëtare e Partisë Demokratike, të cilën nuk e kam fshehur kurrë, përkundrazi. Madje në fushata zgjedhore kam qenë jo pak herë sekretare dhe komisionere e PD-së, në të njëjtën zonë ku ish-ministrja e Arsimit, Lindita Nikolla

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

<sup>3</sup> Plotësuar ankesa më datë 04.01.2023.

<sup>4</sup> Referuar Librezës së Antarësisë Nr. 111768, datë 28.06.2005, ankuesja është anëtare e subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë

<sup>5</sup> Sipas pretendimit të ankueses: “Hakmarrje ndaj kritikave në shtyp”.

ishte kryetare Minibashkie. Njëkohësisht, zonë ku ndodhej shkolla ku unë punoja së fundmi prej 10-vitesh, deri në momentin e largimit nga puna.

Si pasojë e këtyre shkrimeve kritike, shtuar dhe bindjet politike, jam diskriminuar haptazi dhe në forma të ndryshme deri tek familja, pas vitit 2013-të, kur neni 6 i Ligjit 69/2012, “Për Arsimin Parauniversitar”, i ndryshuar, e ndalon kategorikisht këtë. Kam qenë gjithmonë në shenjestër të sulmeve, lojrave, presionit dhe dhunës psikologjike, shqetësimeve të vazhdueshme në vendin e punës dhe jo vetëm, duke më cënuar dinjitetin dhe dëmtuar integritetin profesional dhe moral, shoqëruar me dëshirën për hakmarrje nga drejtoria e Shkollës 9-vjeçare “Marie Logoreci”, Zyra Vendore Arsimore Tiranë, si dhe nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Kjo e fundit pasi unë i jam drejtuar ish ministres në lidhje me problemet që ndeshesha çdo ditë, përfshirë dhe diskriminimin në konkursin e vitit 2016-të, për drejtor në shkollën 9-vjeçare “Emin Duraku” Tiranë. Komunikimin me të e nisa fillimisht në funksion të një arsimi më cilësor, e-maillet e mia drejtuar ministres datojnë që prej vitit 2014, por znj. Ministre jo vetëm që nuk mori asnjë masë, por nuk ktheu asnjëherë përgjigje.

Në datën 30.04.2019, unë jam larguar nga detyra si mësuese e profilit Matematikë në shkollën 9- vjeçare “Marie Logoreci” në mënyrë të padrejtë. Largimi nga detyra nuk është i vetmi dëm që më është bërë pasi unë jam trajtuar në mënyrë çnjerëzore pas vitit 2013-të, jo vetëm gjatë ushimit të detyrës si mësuese, por dhe në momentin e largimit nga puna duke përfshirë edhe Policinë e Shtetit ku polic dhe civilë të Komisariatit nr. 1, të Tiranës më kanë mbajtur dy orë mbyllur në sallën e mësuesve me trajtime çnjerëzore duke mos më lënë as të shkoj të kryej nevojat personale...dhe për çudi në fund ikën sikur nuk kishte ndodhur asgjë. Duke qenë se kjo çështje është në proces gjyqësor në gjykatë, unë ia kam lënë në dorë drejtësisë të merret me këtë problem, por para se t’i drejtohesha Gjykatës së Rrethit Gjyqësor me padi, unë kam respektuar hierarkinë e institucioneve si një njohëse e mirë e ligjit dhe e kujdesshme për ta zbatuar atë deri në fund, edhe pse pritshmëritë e zgjidhjes së problematikës ishin në nivel të ulët.

Problemi im tani është se, nisur që nga Zyra Vendore Arsimore Tiranë (ZVA) e deri tek Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) vazhdon ndaj meje diskriminimi i shumëfishtë.

Më duhet të theksoj se diskriminimi im në raport me të drejtën për tu zgjedhur, ka qenë i dukshëm që në vitin 2016 në konkursin që Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë (DART), sot ZVA Tiranë, hapi për drejtor në shkollën 9-vjeçare, “Emin Duraku” Tiranë, ku sipas vlerësimit të dosjeve unë isha në vendin e parë me gati 2-fishin e pikëve të kandidatit që u zgjodh si fitues i konkursit edhe pse më ishin mohuar shumë pikë nga botimet e mia, apo si bashkëautore në hartimin e Standardeve të mësuesit të matematikës, Programeve lëndore të matematikës për shkollën e mesme të ulët, si dhe të qenit redaktore shkencore e tyre etj. Tentativa për të më shmangur nga konkursi ishte me makinacione të turpshme, por unë gjeta mënyrat që t’ia dështoj këto makinacione. Pavarësisht këtyre, ato luajtën me pikët e dosjes dhe në fund me keqpërdorimin e asaj që, “fituesin e zgjedh drejtuesi” edhe pse sërish unë isha në vendin e parë me dosje. Pas ankimit ku unë kërkoja vlerësim të gjithë dokumentacionit të dorëzuar, çuditërisht jo që nuk u vlerësuan, por më ulën edhe 100 pikë, si e si që të justifikonin mosnxjerrjen time si fituese përfundimtare edhe pse prapë me dosje mbeta në vendin e parë.

Me shmangie dhe diskriminim të hapur në zbatim të procedurave, u veprua edhe kur unë konkurova në konkursin e vitit 2020 për drejtues në shkollën Speciale “Luigj Gurakuqi”, Tiranë,

ku konkursi nuk prodhoi fitues, pra degradoi në një konkurs fals, ku si drejtues mbeti ish-drejtuesi që realisht kishte dalë në pension. Edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë monitorimit në këtë zyrë (ZVA Tiranë, pjesë e DRAP Durrës), ka konstatuar parregullsi në konkurse, ndër to mosshënim në protokollin e zyrës të disa gjerave, të cilat sipas meje mund ta ndihmonin një ankimues në nxjerrjen e së vërtetës.

Edhe pse ka vite që kanë kaluar këto dy raste të diskriminimit tim në konkurimet e viteve 2016, 2020, në veçanti ai i vitit 2016-s, dhe unë i jam drejtuar ministrisë, i kam ngritur si në shtypin e shkruar me opinione apo i jam drejtuar publikisht edhe kryeministrit të vendit (Opinionet: “Meqë po na pyet z. Kryeministër”- Gazeta Shqiptare; “Konkurset false për drejtor shkolle” - Gazeta, Shekulli , SOT, etj ) i tregova për të arritur tek rasti për të cilin, po ju drejtohem tani me këtë ankesë që d.m.th. diskriminimi për shkak të fjalës së lirë dhe bindjeve politike është instaluar në të gjitha institucionet sipas hierarkisë.

Ky rast që po ka të bëjë me një lloj diskriminimi i cili është bërë nga institucioni më i lartë i arsimit, Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), kur zhvilloi konkursin për Drejtor të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP), duke bërë përpjekje të dukshme, madje publike që unë të skualifikohesha që në fazën e parë të këtij konkursi.

Konkretisht: Shpallja për pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, u bë nëpërmjet urdhërit nr. 217, datë 21.04.2022. Në këtë urdhër përcaktohej si afat i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët data 04.05.2022. Unë kam dorëzuar dokumentacionin ditën e fundit të afatit të lejuar, me 04.05.2022, pranë MAS, ku edhe gjatë dorëzimit u shfaqën tentativa për mospranimin e dokumentacionit tim. Ndërkohë që me datën 09.05.2022, në faqen zyrtare të MAS, duhet të shpallej lista e kandidatëve të kualifikuar për të vazhduar procedurat e konkurimit, sipas përcaktimeve në shtojcën bashkëlidhur këtij urdhëri, MAS nxjerr urdhërin nr.240, datë 05.05.2022, në të cilin ndryshohet data e dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët e cila bëhet 10.05.2022 nga 04.05.2022 që ishte në urdhërin e parë, duke mos na vënë në dijeni kandidatët e deriatëhershëm (të paktën mua, jo). Përpos, futen edhe disa ndryshime në kriteret. Shkaku i këtij ndryshimi nuk thuhet, por nuk është vështirë të kuptohet, që sapo unë u shfaqta si kandidate (ditën e fundit) në këtë konkurs, filluan makinacionet për të më skualifikuar, mjafton ti referoheni ndryshimeve në urdhërin e dytë. Diçka që bie në sy në këtë urdhër të dytë, është se mungon data e shpalljes së listës së kandidatëve që do të përzgjidhen (është lënë bosh).

Me 12.05.2022, lajmërohem me e-mail nga një punonjës i sektorit të menaxhimit të burimeve njerëzore në MAS, se nuk jam kualifikuar për të marrë pjesë në fazën e dytë të konkursit, për arsye të mungesës së kopjes së librezës së punës. Përpos, aty citohej e drejta e ankimimit dhe afati. Duke respektuar këtë afat, unë ankimova këtë rezultat duke çuar dhe kopje të librezës së punës. Ndërsa gjatë dorëzimit të kërkesës dhe dokumentacionit përkatës, ka patur një tendencë të pakuptimtë për mospranim të tyre (timin si kandidate) madje nuk u dha numër protokollin apo një mënyrë tjetër konfirmimi të dorëzimit të dokumentacionit për konkurrim, gjatë dorëzimit të ankimimit është kërkuar me ngulm firma e dorëzuesit në protokoll.

Pas ankimimit, nuk pati përgjigje derisa mu desh të nis një ri-ankimim me datë 23.05.2022, ku ndër të tjera citova për mënyrat e përdorura, unë ndihem e diskriminuar. Atëherë, më erdhi një përgjigje, ku për çudi nxorren shkak tjetër të moskualifikimit tim për të vazhduar konkurimin.

*Shkeljet procedurale vazhduan edhe në fazën e shpalljes së fituesit, ku pa e shpallur fituesin në faqen zyrtare të MAS, sipas përcaktimeve në shtojcat e urdhrave përkatës, MAS çuditërisht nxiton të prezantojë fituesen e përzgjedhur si drejtoreshë në institucionin përkatës, me datë 24.05.2022 dhe këtë event e hedh ministria, në faqen e saj Facebook. Unë reagoja edhe me koment ndaj këtij konkursi ku i kujtova ministres, ndër të tjera, që është hera e tretë që unë po diskriminohem në mënyra të turpshme në konkurse të bëra nga ZVA Tiranë dhe MAS. Fakti që unë nisa ri-ankimimin me 23.04.2022 dhe prezantimi i fituesit ndodhi më 24.05.2022, direkt në institucion pa njoftuar fituesin në faqen zyrtare, tregon nxitimin e tyre për ta bërë fakt të kryer drejtorin e përzgjedhur, paçka nëse ishte e drejtë përzgjedhja apo jo.*

*Kam pritur, deri në mbyllje të vitit 2022 (duke futur mirkuptimin për muajt korrik- gusht si muaj pushimesh për shumicën e punonjësve) një reflektim nga Ministria e Arsimit dhe tani vendosa t'ju drejtohem ju si institucion, për të kuptuar se diskriminimi për shkak të fjalës së lirë nuk ka kufi nga institucionet në arsim dhe jo vetëm. Shtuar këtu dhe atë për bindjet partiake, si e djathtë.*

*Sjell në vëmendje se, të gjitha pretendimet që citova për dy rastet e tjera të konkurimit, mund të verifikohen lehtësisht tek dokumentacioni i konkursit, i cili arkivohet në shkollat përkatëse pas mbarimit të konkursit... ”.*

Sa më sipër, pala ankuese kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjeve politike dhe qëndrimeve kritike, nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Gjithashtu, ankuesja ka kërkuar marrjen e masave për përcaktimin e pozicionit të saj real në konkursin e zhvilluar.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010, i ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 123/1 prot., datë 01.02.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrime Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.

Me shkresën<sup>6</sup> nr. 706/1 prot., datë 16.02.2023, MAS ka njohur Komisionerin me qëndrimin e saj, lidhur me sa ka pretenduar subjekti ankues, duke parashtruar ndër të tjera, se:

*“...Me urdhrin nr. 217, datë 21.04.2022, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për shpalljen e pozicionit të drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar” (referuar “Urdhri nr. 217, datë 21.04.2022”), është shpallur konkurrimi për pozicionin e drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (referuar ‘DPAP’), bazuar në rregulloren ‘Për rregullat dhe procedurat e konkurrimit për pranimin dhe lirin nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj”, (referuar “Rregullore”), neni 6, pika 1. Në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri përcaktoheshin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, dokumentacioni dhe afati për dorëzimin e tij, përshkrimi përgjithësues për pozicionin e shpallur etj, vendi dhe data e dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët e interesuar.*

*Me urdhrin nr. 240, datë 05.05.2022, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për një shtesë dhe ndryshim në urdhrin nr. 217, datë 21.04.2022 “Për shpalljen e pozicionit të drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, (referuar “Urdhri nr. 240, datë 05.05.2022”) është përcaktuar: Në urdhrin nr. 217, datë 21.04.2022 “Për shpalljen e pozicionit të drejtorit të drejtorisë së përgjithshme të arsimit parauniversitar”, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë:*

- a. Pika 3 ndryshohet si vijon: 3. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët për Drejtor të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, do të jetë deri në datën 10.05.2022
- b. Shtojca nr. 1 zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

*Nga përmbajtja e shtojcës nr. 1, bashkëlidhur Urdhrit nr. 240, datë 05.05.2022, i cili ka ndryshuar Urdhrin nr. 217, datë 21.04.2022, rezulton se nuk kanë ndryshuar kërkesat e përgjithshme dhe kërkesat e veçanta që duhet të plotësonin kandidatët, ndryshe nga sa pretendon ankuesja. Në përfundim të afatit të përcaktuar me Urdhrin nr. 240, datë 05.05.2022, në MAS janë depozituar 19 aplikime. Aplikimi i F. G. është protokolluar me nr. 3093 prot., datë 04.05.2022.*

<sup>6</sup> Protokolluar pranë KMD-së me nr. 123/2 prot., datë 16.02.2023.

Me urdhrin nr. 260, datë 12.05.2022, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për ngritjen e komisionit për procedurën e konkurrimit në pozicionin Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, është ngritur komisioni bazuar në nenin 7 pika 7 të Rregullores.

Me datë 12.05.2022, F. G. është njoftuar, me email, nga MAS se nuk është kualifikuar për të marrë pjesë në fazën e dytë të konkurrimit sepse i mungonte librezja e punës si dokumenti që vërteton eksperiencën në punë. Më datë 13.05.2022, F. G. ka depozituar ankesën për konkurrimin e drejtuesit të DPAP-së, e cila është protokolluar në MAS me nr. 3093/1 prot., datë 13.05.2022. Bashkëlidhur kësaj ankese F. G. ka dërguar kopjen e noterizuar të librezës së punës.

Në datën 12.05.2022, nëpërmjet e-mailit, janë njoftuar nga MAS katër kandidatë të tjerë të cilët nuk janë kualifikuar për të marrë pjesë në fazën e dytë të konkurrimit, për shkak se:

- i. B. N., i mungonte dokumenti (librezë pune) që vërteton eksperiencën në punë (për të njëjtin shkak si ankuesja);
- ii. A. H., nuk plotësonte kriterin e vjetërsisë si drejtuese në institucionet arsimore si dhe institucionet arsimore përgjegjëse për arsimin parauniversitar;
- iii. V. M., nuk plotësonte kriterin e vjetërsisë si drejtuese në institucionet arsimore si dhe institucionet arsimore përgjegjëse për arsimin parauniversitar;
- iv. E. H., nuk plotësonte kriterin e diplomës master shkencor në fushën e mësuesisë; përvojë pune në profesion, nga të cilat të paktën 5 vite si drejtues në institucione arsimore si dhe në institucionet përgjegjëse për arsimin parauniversitar; kategorinë e II të kualifikimit si mësues;

Në datën 12.05.2022, nëpërmjet emailit janë njoftuar nga MAS kandidatët të cilët kishin mungesa në dokumentacionin e dorëzuar me qëllim që ta dorëzonin atë brenda afatit 3 ditor, pasi në rast të kundërt mos dorëzimi i tij do të përbënte shkak për skualifikim. Kandidatët e njoftuar me email janë: Z. M., A. H., B. P., E. A., E. Xh., A. B., V. Sh., H. G., P. E., V. B.

Në datën 17.05.2022 nga komisioni i ngritur me urdhrin nr. 260, datë 12.05.2022, është mbajtur procesverbal nga përmbajtja e të cilit rezulton se janë kualifikuar 8 (tetë) kandidatë dhe janë skualifikuar 11 kandidatë të tjerë. Nga 11 kandidatët e skualifikuar vetëm F. G. dhe B. N. kanë paraqitur ankim. Në lidhje me skualifikimin e F. G. në procesverbalin e mbajtur nga ky komision në pjesën “Kandidatët e skualifikuar që kanë ankimuar janë”, citohet: “1. F. G. ka dorëzuar librezën e punës nga ku konstatohet se nuk përmbush kërkesën e vjetërsisë në punë e cila duhet të jetë mbi 15 vjet në profesion nga të cilat 5 vite si drejtues në institucione arsimore si dhe në institucionet përgjegjëse për arsimin parauniversitar. F. G. ka vetëm 4 vite pune si drejtues.”

Me datë 17.05.2022, në faqen web të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit është publikuar “Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak”, me emrat e 8 kandidatëve të kualifikuar për të vazhduar fazën të dytë të konkurrimit, atë të testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Në datën 23.05.2022, nga MAS i është dërguar email F. G. nëpërmjet të cilit i bëhej me dije se nuk ishte kualifikuar për të vijuar në fazat e tjera të konkurrimit për pozicionin, drejtori i përgjithshëm i DPAP-së, pasi pas dorëzimit të kopjes së librezës së punës, në periudhën e ankimit, u konstatua se nuk plotësonte 5 vite si drejtues në institucionet arsimore si dhe institucionet përgjegjëse për arsimin parauniversitar...”.

*Në përfundim, për sa më sipër vlerësojmë se F. G. nuk është diskriminuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për shkak të bindjeve të saj politike si dhe për shkakun tjetër të pretenduar dhe që lidhet me hakmarrjen për shkak të kritikave në shtyp, por për arsye të mosplotësimit të kriterëve.”.*

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm**

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankuesit, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimi e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”.*

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Në nenin 5, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet se: “1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedurë, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”.

Në Kreun II, të LMD-së parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. LMD në nenin 12/1/b<sup>7</sup>, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një personi në lidhje me të drejtën për punësim.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesin në të drejtën e tij për punësim, duke përfshirë këtu edhe momentin e përfundimit e marrëdhënieve të punës;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ajo i është nënshtruar ndonjë trajtimi të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e saj në lidhje me procedurat e konkurrimit për pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

Ankuesja, F. G. ka ushtruar profesionin e mësuesit në profilin Matematikë-Fizikë prej rreth 30 vitesh. Në muajin prill 2022, ka marrë dizeni mbi shpalljen e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit lidhur me pozicionin e punës Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

Sipas provave të administruara, me urdhrin nr. 217, datë 21.04.2022, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për shpalljen e pozicionit të Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, është shpallur konkurrimi për pozicionin e drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

Rregullorja e miratuar me urdhrin nr. 454, datë 13.09.2019 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për rregullat dhe procedurat e konkurrimit për pranimin dhe lirin nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj”, në nenin 6, pika 1 të saj

---

<sup>7</sup> Neni 12/1/b, të ligjit nr. 10221/2010: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve;..”.



parashikon: “1. Në bazë të planit vjetor të pranimeve të miratuara me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin bëhet shpallja për konkurim nga njësia përgjegjëse për burimet njerëzore në drejtorinë qendrore të DPAP. Shpallja për konkurim për pozicionin Drejtor i Përgjithshëm apo Drejtor i Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar bëhet nga njësia përgjegjëse për burimet njerëzore në MASR”. Në këtë kuptim, më datë 22.04.2022, në faqen zyrtare të MAS, është bërë publikimi i pozicionit vakant për Drejtor të Përgjithshëm të DPAP-së.

Sipas urdhrit nr. 217, datë 21.04.2022 të publikuar nga MAS, për pozicionin Drejtor të Përgjithshëm të DPAP-së, citohej se: “...2. Përzgjedhja e drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar të kryhet në përputhje me kriteret, procedurën dhe dokumentacionin që duhet dorëzuar, sipas përcaktimeve në shtojcën nr. 1, bashkëngjitur këtij urdhri.”. Afati për dorëzimin e dokumentacionit nga kandidatët ishte përcaktuar data 04.05.2022.

Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësoj kandidati për pozicionin e mësipërm, janë si vijon:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi për të vepruar;
3. Të mos jetë i dënues për vepra penale dhe të mos ketë proces penal të hapur në prokurori apo gjykatë;
4. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
5. Nuk duhet të jetë anëtar në forumet drejtuese të partive politike.

Kërkesat e veçanta që duhet të plotësoj kandidati për pozicionin e mësipërm, janë si vijon::

1. Të jetë pajisur me diplomën master shkencor në fushën e mësuesisë;
2. Të ketë mbi 15 vite përvojë pune në profesion, nga të cilat të paktën 5 vite si drejtues në institucione arsimore si dhe në institucionet përgjegjëse për arsimin parauniversitar;
3. Të ketë kategorinë e II të kualifikimit si mësues;
4. Zotërimi i gjuhëve të huaja përbën avantazh (dëshmi, certifikata).

Në pikën e 3-të të publikimit, janë vendosur dokumentacionet që duhet të dorëzonin kandidatët, si më poshtë: “Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë”:

1. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/legislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard;>
2. Letër motivimi;
3. Diplomë master shkencor, (për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit);
4. Listë notash e noterizuar për nivelin bachelor dhe master;
5. Certifikatë që vërteton shkallën e kualifikimit;
6. Certifikatë për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme;
7. Librezë pune; (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë)
8. Fotokopje e kartës së identitetit;
9. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
10. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

Në vijim, Ministri për Arsimin dhe Sportin, miratoi urdhrin nr. 240, datë 05.05.2022 “Për një shtesë dhe ndryshim në urdhrin nr. 217, datë 21.04.2022 “Për shpalljen e pozicionit të drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”. Në pikën 1 të këtij urdhri përcaktohej se: “1. Në urdhrin nr. 217, datë 21.04.2022 “Për shpalljen e pozicionit të drejtorit të drejtorisë së përgjithshme të arsimit parauniversitar”, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë:

a. Pika 3 ndryshohet si vijon:

3. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët për Drejtor të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, do të jetë deri në datën 10.05.2022.

b. Shtojca nr. 1 zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.”

Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësoj kandidati sipas urdhrit 240, datë 05.05.2022, për pozicionin e mësipërm, janë si vijon:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale dhe të mos jetë në ndjekje penale në prokurori apo në proces gjyqësor në gjykatë;
4. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
5. Të mos jetë anëtar në forumet drejtuese të partive politike.

Kërkesat e veçanta që duhet të plotësoj kandidati për pozicionin e mësipërm, janë si vijon::

1. Të jetë pajisur me diplomën “Master i shkencave” në fushën e mësuesisë;
2. Të ketë mbi 15 vite përvojë pune në profesion, nga të cilat të paktën 5 vite si drejtues në institucione arsimore si dhe në institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar;
3. Të ketë kategorinë e II të kualifikimit si mësues;
4. Zotërimi i gjuhëve të huaja përbën avantazh (dëshmi, certifikata).

Në pikën e 3-të të publikimit, janë vendosur dokumentacionet që duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë”:

1. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>;
2. Letër motivimi;
3. Diplomë e studimeve të larta “Master i shkencave”, në fushën e mësuesisë (për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga institucioni përgjegjës për njohjen dhe njehsimin në Republikën e Shqipërisë);
4. Listë notash e noterizuar për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve;
5. Certifikatë që vërteton shkallën e kualifikimit;
6. Certifikatë për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme;
7. Librezë pune; (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë)
8. Fotokopje e kartës së identitetit;
9. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

10. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
11. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
12. Vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale;
13. Vërtetim gjyqësor nga gjykata që nuk ka proces penal.

*Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër duhet të paraqitet, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, brenda datës 10.05.2022, i cili duhet të protokollohet pranë këtij institucioni.*

Referuar Kartelës Shoqëruese të Praktikës, të protokolluar nga MAS me nr. 3093, datë 04.05.2022, rezulton se ankuesja në datë 03.05.2022 ka dorëzuar kërkesën për konkurim dhe dokumentacionin për pozicionin e drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

Nga informacioni i administruar, për pozicionin e drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, kanë shprehur interesin 19 kandidatë, të cilët kanë aplikuar brenda afateve të përcaktuara në urdhrat e sipërcituar të MAS. Nga përmbajtja e shtojcës nr. 1, bashkëlidhur Urdhrit nr. 240, datë 05.05.2022, i cili ka ndryshuar Urdhrit nr. 217, datë 21.04.2022, nuk rezulton se kërkesat e përgjithshme dhe ato të veçanta që duhet të plotësonin kandidatët prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë ankuesen apo procedurën e konkurimit, ndryshe nga sa pretendon ankuesja.

Neni 7 i Rregullores “Për rregullat dhe procedurat e konkurrimit për pranimin dhe lirimimin nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj”, përcakton se: “Përjashtimisht kur procedura e pranimit zhvillohet për pozicionin Drejtor i Përgjithshëm të DPAP apo Drejtor Drejtorie Rajonale, përfaqësuesit e komisionit Ad-Hoc, përcaktohen nga ministri përgjegjës për arsimin”.

Përsa është përcaktuar edhe në rregulloren e sipërcituar, pas përfundimit të afateve për dorëzimin e aplikimeve, me urdhrin nr. 260, datë 12.05.2022, të MAS “Për ngritjen e komisionit për procedurën e konkurrimit në pozicionin Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, është ngritur komisioni Ad-Hoc për vlerësimin e kandidatëve.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar rezulton se MAS, në vijim të procedurës për përzgjedhjen e drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, më datë 12.05.2022, janë njoftuar aplikantët të cilët nuk janë kualifikuar për të marrë pjesë në fazën e dytë të konkurrimit, si më poshtë:

1. *F. G., i mungonte librezja e punës si dokumenti që vërteton eksperiencën në punë.*
2. *B. N., i mungonte dokumenti (librezë pune) që vërteton eksperiencën në punë;*
3. *A. H., nuk plotësonte kriterin e vjetërsisë si drejtuese në institucionet arsimore si dhe institucionet arsimore përgjegjëse për arsimin parauniversitar;*
4. *V. M., nuk plotësonte kriterin e vjetërsisë si drejtuese në institucionet arsimore si dhe institucionet arsimore përgjegjëse për arsimin parauniversitar;*
5. *E. H., nuk plotësonte kriterin e diplomës master shkencor në fushën e mësuesisë; përvojë pune në profesion, nga të cilat të paktën 5 vite si drejtues në institucione arsimore si dhe në*

*institucionet përgjegjës për arsimin parauniversitar; kategorinë e II të kualifikimit si mësues;*

Gjithashtu, veç kandidatëve të sipërcituar, nga ana e Sektorit të Burimeve Njerëzore të MAS, më datë 12.05.2022, nëpërmjet e-mail-it janë njoftuar nga MAS edhe kandidatët të cilët kishin mungesa në dokumentacionin e dorëzuar me qëllim që ta dorëzonin atë brenda afatit 3 ditor, pasi në rast të kundërt mos dorëzimi i tij do të përbënte shkak për skualifikim. Kandidatët e njoftuar me email janë: Z. M., A. H., B. P., E. A., E. Xh., A. B., V. Sh., H. G., P. E., V. B.

Në analizë të informacionit të sipërcituar, në fazën e parë të konkurrimit për pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të DPAP-së, komisioni Ad-Hoc, pas vlerësimit të dosjeve të kandidatëve ka evidentuar se F. G. dhe një nga kandidatet pjesëmarrëse, nuk kishin dorëzuar librezat e punës për të vërtetuar eksperiencën në punë. Të dyja kandidatet janë njoftuar që sipas urdhrin nr. 240, datë 05.05.2022, kanë të drejtën e ankimimit brenda 3 (tre) ditëve nga marrja dijeni pranë njësisë përgjegjëse për burimet njerëzore në MAS.

Përsa më sipër, F. G. dhe kandidatja tjetër e skualifikuar për të njëjtin shkak i janë drejtuar me anë të e-mail-it me ankim njësisë së burimeve njerëzore në MAS. Më datë 13.05.2022, F. G. ka depozituar ankesën për konkurrimin e drejtuesit të DPAP-së, e cila është protokolluar në MAS me nr. 3093/1 prot., datë 13.05.2022.

Referuar Procesverbalit të mbajtur më datë 17.05.2022 nga komisioni Ad-hoc, i ngritur me urdhrin nr. 260, datë 12.05.2022, evidentohet se janë kualifikuar 8 (tetë) kandidatë dhe janë skualifikuar 11 kandidatë të tjerë. Lidhur me këtë, nga 11 kandidatët e skualifikuar vetëm F. G. dhe B. N., kanë paraqitur ankim. Sipas përmbajtjes së procesverbalit, në pjesën *“Kandidatët e skualifikuar që kanë ankimuar janë”*, citohet: *“1. F. G. ka dorëzuar librezën e punës nga ku konstatohet se nuk përmbush kërkesën e vjetërsisë në punë e cila duhet të jetë mbi 15 vjet në profesion nga të cilat 5 vite si drejtues në institucione arsimore si dhe në institucionet përgjegjëse për arsimin parauniversitar. F. G. ka vetëm 4 vite pune si drejtues”*.

Në të njëjtën datë, më 17.05.2022, në faqen web të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit është publikuar *“Njoftim mbi rezultate e verifikimit paraparak”*<sup>8</sup>, me emrat e 8 kandidatëve të kualifikuar për të vazhduar fazën të dytë të konkurrimit, atë të testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Në datën 23.05.2022, ankuesja i është drejtuar njësisë së burimeve njerëzore të MAS me ankim mbi konkursin për Drejtor të Drejtorisë së Përgjithshme të DPAP-së. Në e-mail-in e vënë në dispozicion, ankuesja ndër të tjera i ka sqaruar MAS se: *“Referuar e-mailit të nisur nga ju,...mbi “Moskualifikimin tim...” si dhe listës me kandidatët e kualifikuar - publikuar në faqen e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, më 17.05.2022, ju bëj me dije, se ditën e nesërme (pas njoftimit tuaj) unë kam paraqitur një ankimim (ku kam bashkëngjitur kopjen e librezës së punës të noterizuar) i cili është dorëzuar tek Informacioni i MAS. Ankimi ka qenë brenda afateve kohore, por për të nuk kam*

<sup>8</sup> <https://arsimi.gov.al/njoftim-mbi-rezultatet-e-verifikimit-paraparak/>

*marrë ende përgjigje. Përpos, në listën e kandidatëve të shpallur pas verifikimit paraprak nuk ishte reflektuar emri im. Kujtoj që, nga praktikat e konkurseve në arsim, “komisionet”- gjatë verifikimit paraprak nëse konstatojnë ndonjë mungesë dokumentacioni (qoftë dhe e quajtur mungesë sipas tyre) njoftojnë aplikantët me e-mail mbi mangësitë në dokumentacion si mundësi plotësimi, para nxjerrjes së rezultateve të verifikimit paraprak. Nëse i referohemi shpalljes që MAS ka publikuar për këtë konkurs, harku kohor nga data e dorëzimit përfundimtar të dokumentacionit deri në datën e lënë në shpalljen e MAS, për daljen e rezultateve, e hapësira për të bërë plotësim në dokumentacion. Në të kundërt lista do të ishte shpallur nga ju që ditën që nisët e-mail-in tek unë. Nëse juve si komision të ngritur nga MAS, në rastin në fjalë - që për mua ende mbeten anonim, një “harresë” njerëzore ju vjen për shtat për të skualifikuar të padëshiruarit, kjo është çështje tjetër. Sjell dhe diçka në vëmendjen tuaj.*

*Kur Departamenti i Administratës Publike i reflekton kandidatët pas plotësimit të dokumentacionit, juve si komision, në këtë rast, çfarë ju shtyn të mos i reflektoni ?!*

*Moskthimi i përgjigjes për ankimin, mosmarrja parasysh e plotësimit të dokumentacionit dhe vazhdimi i procedurës pa qartësuar aplikantët e skualifikuar (si unë), tregon qartë që ky konkurs është facilitet. Përsa më sipër, unë personalisht ndihem, në këtë rast, e diskriminuar...”.*

Në të njëjtën datë, më 23.05.2022, nga MAS i është dërguar email F. G. nëpërmjet të cilit i bëhej me dije se nuk ishte kualifikuar për të vijuar në fazat e tjera të konkurrimit për pozicionin, drejtori i përgjithshëm i DPAP-së, pasi pas dorëzimit të kopjes së librezës së punës, në periudhën e ankimit, u konstatua se nuk plotësonte 5 vite si drejtues në institucionet arsimore si dhe institucionet përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga palët, rezulton se MAS ka ndjekur të njëjtën procedurë dhe ka mbajtur të njëjtin qëndrim gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit, për të gjithë konkurentët për pozicionin e sipërcituar. Referuar njoftimeve për verifikimin paraprak të dosjeve, rezulton se njësia e burimeve njerëzore e MAS, përveç ankueses ka skualifikuar dhe një kandidatë tjetër, B. N. për mungesë dokumentacioni (librezën e punës).

Mbështetur në provat e administruara, pas ankimit ankuesja dhe kandidatja B. N., rezulton që kanë dorëzuar dokumentacionin e kërkuar sipas shpalljes së publikuar nuk janë kualifikuar për të vazhduar konkurimin, pasi nuk plotësonin eksperiencën e punës, 5 vite si drejtues në institucionet arsimore si dhe institucionet përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

Në analizë të provave të administruara dhe pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues, Komisioneri konstatoi se:

- Nga përmbajtja e shtojcës nr. 1, bashkëlidhur Urdhrit nr. 240, datë 05.05.2022, i cili ka ndryshuar Urdhrit nr. 217, datë 21.04.2022, janë bërë ndryshime në kërkesat e përgjithshme dhe ato të veçanta që duhet të plotësonin kandidatët, por ato nuk konstatohet se preknin apo përjashtonin ankuesen nga konkurimi për pozicionin vakant, ndryshe nga sa ajo pretendon;

- Nuk u evidentua të ketë patur ndonjë tendencë gjatë procedurave të konkurimit, për përjashtimin e ankueses, pasi provohet se është ndjekur e njëjta procedurë si për ankuesen dhe kandidatët e tjerë pjesëmarrës në konkurim;
- Referuar nenit 13, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “1. Punëdhënësi është i detyruar: a) të zbatojë, të mbrojë e të nxisë parimin e barazisë dhe të ndalimit të çdo lloj diskriminimi; b) të marrë masat e nevojshme, përfshirë dhe masa disiplinore, për mbrojtjen e punëmarrësve nga diskriminimi dhe viktimizimi, brenda një muaji nga marrja e dënjësive; c) t’u përgjigjet efektivisht dhe në përputhje me këtë ligj ankimeve të marra për shkak të diskriminimit të kryer nga punëmarrësit e tij, brenda një muaji nga marrja e tyre...;”, njësia e burimeve njerëzore të MAS, ka reaguar në mënyrë të menjëhershme, brenda ditës, më datë 23.05.2022 lidhur me ankesën e F. G. për diskriminim, duke i kthyer përgjigje sa i përket pretendimeve të ngritura prej saj;
- Nga provat e administruara, në mbështetje të parashikimeve në urdhrin e Ministrit “Për shpalljen e pozicionit të drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, ankuesja është informuar me e-mail dhe nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të MAS nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të MAS, për të gjitha fazat e konkurimit, në të njëjtën mënyrë me kandidatët e tjerë.

Për sa më sipër, pas analizës së të gjithë fakteve dhe provave në këtë proces shqyrtimi administrativ të ankesës nr. 15, datë 19.01.2023, të F. G., Komisioneri gjykon se Ministria e Arsimit dhe Sportit, nuk e ka ekspozuar ankuesen ndaj një trajtimi të padrejtë e disfavorizues, sa i përket procedurave të konkurimit për pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, F. G., për shkaqet e pretenduara, nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në fushën e punësimit.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dënjësive.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Bindja politike dhe çdo shkak tjetër)

(Fusha: Punësim)